



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.32/14 prot

Datë 11.02.2026

V E N D I M

Nr. 245/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.02.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 136/2026, datë 26.01.2026 për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “*FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH*”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Eduart Xhixha” PF, me NUIS L54424205B me adresë: Ndertese private, 2 kateshe, kati pare mbi toke, zona kadastrale nr. 3096, me numer pasurie 97/32/1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës, me adresë: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 26.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 136/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eduart Xhixha” PF, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës në zbatim të Vendimit të KSHA-së nr.345/1 prot., datë 16.01.2026 “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Eduart Xhixha” pf për procedurën me objekt ankimi: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, me REF-65957-10-21-2025, dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eduart Xhixha” PF.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.345/7 prot., datë 03.02.2026, protokolluar me tonën nr. 32/11 prot., datë 05.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Durrës informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 136/2026, datë 26.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, bashkëngjitur procesverbali i rivlerësimit datë 30.01.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.345/7 prot., datë 03.02.2026, protokolluar me tonën nr. 32/11 prot., datë 05.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Durrës informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 136/2026, datë 26.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “FV mobileri pajisje në

ambientet e brendshme të MZSH”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, bashkëngjitur procesverbali i rivlerësimit datë 30.01.2026.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 136/2026, datë 26.01.2026. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 136/2026, datë 26.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin e KSHA-së dhe arsyetimet e konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “*FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH*”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

